

## NJERI ME MENDJEN DHE ZEMËR BUJARE



**Mr. Nahid Ipçiu**  
(1945-2021)

Më 18.10.2021 në moshën 76-vjeçare ndërroi jetë Mr. Nahid Ipçiu, njëri ndër profesorët më të nderuar në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës dhe bashkëpunëtor i Institutit Albanologjike në Prishtinë. Ishte dashur nga studentët e tij, për shkak të kulturës dhe thjeshtësisë, dinte të dëgjonte dhe të mësonte.

Nahid Ipçiu lindi në Prizren më 2.10.1945. Rrjedh nga një familje qytetare zejtare. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren. Në vitin shkollor 1965/66 i regjistroi studimet në Degën e Historisë pranë Fakultetit Filozofik në Prishtinë, ku u diplomua në vitin 1969. Pas diplomimit u inkuadrua në Gjimnazin e Prizrenit si profesor i lëndës së historisë duke treguar përgatitje të lartë profesionale dhe pedagogjike.

Në tetor të vitit 1971 zgjidhet asistent i lëndës Historia e Popujve të Jugosllavisë - Koha e Re (për mësim në gjuhën shqipe) në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në vitin shkollor 1971/1972 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Degën e Historisë pranë Fakultetit Filozofik të Beogradit, ku magjistroi më 5.12. 1975 me temën “Kosova në tregtinë ndërkombëtare 1878-1903”. Më 1976 u zgjodh ligjërues i lëndës Historia e Popujve të Jugosllavisë – Koha e Re (shek. XVI-XVIII), e cila në

vitin 1993, sipas planprogramit të ri, u emërtuar si Historia e Popujve të Ballkanit – II.

Në vitin 1995 Mr. Nahid Ipçiu paraqiti tezën e doktoratës me titull "Kosova dhe viset fqinje në tregtinë ndërkombëtare prej gjysmës së dytë të shek. XVIII deri në Kongresin e Berlinit", në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës, por për shkak të rrethanave objektive të kohës nuk arriti ta mbronte.

Profesori u shqua si njohës i mirë i rrethanave ekonomike të Kosovës në shekujt XIX-XX, me ç'rast botoi disa punime shkencore me rëndësi, rezultatete të cilat për kohën kur u publikuan i lanë gjurmë në mendimin historiografik. Të tilla janë punimet: "Kosova në tregtinë ndërkombëtare 1878-1903" (tezë magjistrature-dorëshkrim), Beograd, 1975, f. 1 - 183 (tit. në origjinal "Kosovo u medjunarodoj trgovini 1878-1903): Bibliographia historico-economica Jugoslaviae", Zagreb, 1978 (Dr. S. Rizaj - Mr. N. Ipçiu, koautorë të bibliografisë mbi Kosovën) "Ekonomia dhe marrëdhëniet shoqërore në Kosovë nga kohërat më lashta deri në v. 1918" (projekt i ish-Bashkësisë Krahinore për shkencë). N. Ipçiu është autor i kaptinës: "Tregtia e jashtme prej vitit 1879 deri në vitin 1903: Sferat tregtare të Kosovës dhe të viseve fqinje në gjysmën e dytë të shekullit XIX", *Gjurmime albanologjike - seria e shkencave historike*, nr. 15-1985, Prishtinë, 1986: "Artikujt e eksportit dhe të importit të Kosovës dhe të viseve fqinje në gjysmën e dytë të shekullit XIX", *Gjurmime albanologjike - seria e shkencave historike*, nr. 17-1987, Prishtinë, 1988.

Gjatë punës shumëvjeçare si pedagog në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës është dalluar si me mbajtjen cilësore të mësimit ashtu edhe në marrëdhëniet gjithmonë korrekte me kolegët, por për ne studentët e tij prof. Nahidi mishëronte edukatorin e shkëlqyer, bamirësin, i cili me mirësinë, qetësinë, aftësinë e komunikimit me të rinjtë u dëshmuar mjaft i suksesshëm, pasi çdo takim, bisedë me të, ishte përjetim i thellë, frymëzim për jetë dhe veprimtari pedagogjike-shkencore. Këtë e dëshmojnë njerëzit që patën fat dhe mundësi ta njihnin për së afërmi. Figura e tij është vulosur thellë në historinë e fakultetit, i karakterizuar si njeri me mendjen dhe zemër bujare, me angazhimin e tij në dobi dhe të mirën e kolegëve e të studentëve të tij.

**Prof. ass. dr. Alban Dobrun**

## **KRONIKA SHKENCORE**

